



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.568/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e Isuf Osmani, kandidat për antarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si e bazuar ankesa e Isuf Osmani, kandidat për antarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatin për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga subjekti politik LVV, në Vendvotimin 1832E/01R.

III. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Isuf Osmani, kandidat për antarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), sa i përket vendvotimeve: 1816E, 1807E, 1815E, 1804E, 1809E, 1814E.

A r s y e t i m

Me datën 09.11.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Isuf Osmani, kandidat për antarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me të cilën thekson se është bërë manipulim i votave, në këto Qendra të Votimit, si në: Sfeqël, 1814E/01R, Bradash 1807E, Sibofc 1832E/01R, Kërpimeh 1804E, Shtedime 1815E, Dobratin 1809E, Batllavë 1816E, ku kanë votuar të afërm, por pas rezultatit përfundimtar ka pasur mungesë të provave.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur deklaratën e të afërmeve të tij, të cilët theksojnë se kanë votuar Isa Osmanin, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e PDK-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për kandidatin Isuf Osmani nga subjekti politik PDK, në këto vendvotime: 1814E/01R në Sfeqël të Komunës së Podujevës dhe në 1832E/01R në Siboc, dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur. Si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Lidhur me pjesën e refuzuar të ankesës të vendosur si në pikën III të këtij vendimi, paneli gjeti se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara, sepse nuk janë specifikuar vendvotimet se ku janë bërë parregullsitë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.568/2017 më datën 10.11.2017.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.